



MIRË SE VINI NË UNIVERSITETIN “FAN S. NOLI”

Informim i përgjithshëm për studentët e viteve të para

PROCESI I BOLONJËS



Studimet në Universitetin “Fan S. Noli” organizohen, mbështetur në Deklaratën e Bolonjës, në tri cikle:

- Cikli i parë *Bachelor* ME 180 KREDITE;
- Cikli i dytë *Master Profesional* me 120 kredite;
Master i Shkencave me 120 kredite (Dy vite akademike).
- Cikli i tretë *Doktoratë/Master Ekzekutiv*

Programe profesionale 2-vjeçare pas arsimit të mesëm.

Çfarë është *Procesi i Bolonjës*?

- **Procesi i Bolonjës** është një kuadër reformash mes universiteteve, që ka si qëllim të afrojë sa më shumë sistemet e arsimit të lartë të vendeve të ndryshme, për të arritur në një sistem të arsimit të lartë sa më transparent, të hapur dhe të lirë.
- **Procesi i Bolonjës** zë fill në 19 qershor 1999 nga Deklarata e Bolonjës, e nënshkruar nga 29 vende, që synon përputhjen sa më të madhe të sistemit të arsimit të lartë në Evropë. Shqipëria u bë pjesë e këtij procesi që prej vitit 2003.

Si kryhet njësimi?

- Për të bërë të mundur transmetimin dhe ballafaqimin e cilësisë, nga Komuniteti Evropian u ngrit një komision që hartoi një sistem të përbashkët vlerësimi, që quhet “Sistemi evropian i transferimit të krediteve”, **ECTS** (European Credit Transfer System). Ky sistem bën të mundur matjen e të mësuarit dhe arritjet e studentëve.
- **Sistemi i KREDITEVE që qëndron në bazë të kësaj deklarate ka në qendër ngarkesën e punës që studenti duhet të kryejë për të arritur objektivat e programit të tij të studimit.**



Rast përshkrues

- Nëse një lëndë ka 3 kredite, kjo do të thotë se një student i duhen 75 orë studimi për të arritur rezultate pozitive në të.
- Nga këto ai zhvillon **37 orë studimi** në auditor (gjatë zhvillimit të leksioneve, seminareve, laboratorit etj.) dhe **38 orë studimi** individual jashtë auditorit (kërkim në bibliotekë, punë praktike, përgatitje për detyra kursi, etj.)

Notat 4 -10 shprehin cilësinë e punës së studentit, kreditet matin dhe tregojnë sasinë e punës së kryer nga studentit.

- Studenti, nëse kërkon të transferohet, mund t'i transferojë kreditet e tij në një Universitet tjetër partner.

Njohja me Universitetin

Fakultetet dhe departamentet përkatëse



➤ FAKULTETI I BUJQËSISË:

- a. Departamenti i Agrobiznesit
- b. Departamenti i Agronomisë
- c. Departamenti i Agroushqimit



➤ FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË:

- a. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë
- b. Departamenti i Gjuhëve të Huaja
- c. Departamenti i Histori-Gjeografisë
- d. Departamenti i Edukimit

Njohja me Universitetin

Fakultetet dhe departamentet përkatëse



➤ FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE DHE SHKENCAVE HUMANE:

- a. Departamenti i Shkencave Sociale
- b. Departamenti i Informatikës
- c. Departamenti Biologji-Kimi
- d. Departamenti i Infermierisë
- e. Departamenti i Matematikës



➤ FAKULTETI I EKONOMISË:

- a. Departamenti i Financë - Kontabilitetit
- b. Departamenti i Menaxhimit
- c. Departamenti Marketing- Turizëm

Programet e Studimit

➤ Programet e Ciklit të Parë të Studimeve:

- 180 kredite (ECTS) / kohëzgjatja normale tri vite akademike
- Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.
- Në përfundim të studimeve lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimimit të kryer.

Programet e ciklit të dytë

- **“Master profesional” me** 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.
- Përmbyllen me provim përfundimtar formimi, ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master profesional” në fushën e arsimimit të kryer.
- **Programet master në fushën e mësuesisë** organizohen në 120 kredite dhe zgjatin 2-vite.
- **“Master i shkencave”** jo më pak se 120 kredite formimi / kohëzgjatje normale dy vite akademike.
- Përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimimit të kryer.



Programet e ciklit të tretë

- **Studimet e ciklit të tretë.**
- **Doktoratës:** kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese.
- **Master ekzekutiv:** Ofrohen në 1 ose 2 vite përkatësisht 60 ose 120 kredite.

Viti akademik

2022

2023

- Studimet në UK zhvillohen në vite akademike.
- Data zyrtare e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministri përgjegjës për arsimin.
- Viti akademik organizohet në dy semestra, që realizojnë 20 deri në 25 orë mësimore 50-minutëshe leksione, seminare, praktika, laboratorë etj., në një javë.
- Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi.

Kreditet sipas ETSC-së

- Një kredit = 25 orë mësimore pune të studentit.
- Në vit = 60 kredite ose 1500 orë mësimore pune të studentit (orë në auditor dhe orë pune të pavarura)
- Orët për punë të pavarura jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve mësimore vjetore.
- Ngarkesa mësimore javore në auditor për leksione, seminare, ushtrime e laboratore, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 25 orë mësimore 50-minutëshe.
- Vlerësimi i vazhdueshëm përfaqëson 30% të vlerësimit total.



ECTS Credit
Calculator

Llojet e provimeve

Kontrolli i dijeve mund të bëhet:

- a) me shkrim
- b) me gojë
- c) i kombinuar



Tezat e provimit hartohen nga titullari i disiplinës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.

○ KUJDES!

Gjatë zhvillimit të provimit (me shkrim ose me gojë) nuk lejohet ndërrimi i tezës.

Frekuentimi (Sipas rregullores së UK)



75%

- Është i detyrueshëm deri në masën 75%.



100%

- Frekuentimi i punëve laboratorike dhe mësimit praktik: Është i detyrueshëm në masën 100%, në të kundërt studenti nuk hyn në provimin e lëndës.



100%


- Projektet e kursit: Janë të detyrueshme të shlyhen në masën 100%, në të kundërt studenti nuk hyn në provimin e lëndës.

Organizimi i provimeve

- Në orët e fundit të mësimit ***pedagogu*** i komunikon studentit:
 - a. *fitimin ose jo të së drejtës për t'u futur në provimin e lëndës.*
 - b. *Rezultatin e vlerësimit të vazhdueshëm në seminare, laboratore, tema e detyra kursi.*
- Dy ditë para provimit vendos online këto rezultate dhe printon listën emërore të studentëve të regjistruar.
- Lejohet ndërrimi i tezës në provimin me gojë, por ndëshkohet me një zbritje prej dy notash në shkallën prej 10 notash të vlerësimit.



Organizimi i provimeve



- Në sezonin plotësues studenti mund të shlyejë vetëm provimet e mbartura nga vitet e mëparshme.
- Në sezonin e vjeshtës mund të shlyejë në total 14 provime, por jo më shumë se 2 (dy) provime në një ditë.
- Në sezonin plotësues studenti mund të shlyejë deri në 6 provime por jo më shumë se dy në ditë

- Provimet dhe riprovimet zhvillohen në 5 sezone:
 - i. sezoni i dimrit (shkurt, mars)
 - ii. sezoni i verës (qershor, korrik)
 - iii. sezoni i vjeshtës (shtator)
 - iv. sezoni plotësues
 - v. sezoni para provimit të diplomës me tre provime.
- Kohëzgjatja e provimit - jo më shumë se 2 orë.
- Pas dhënies së tezës në provimin me shkrim, nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjerë të grupit apo kursit përkatës.

Ankimimi për provim

- *Studenti ka të drejtë të ankohet* në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose për vlerësim të pamërituar.
- Ankesa bëhet me shkrim:
 - a. Brenda ditës së marrjes së rezultatit për provimin me gojë
 - b. Jo më vonë se 8 ditë për provimin me shkrim nga data e dhënies së tij dhe i drejtohet dekanit të fakultetit.
- Dekani përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës brenda dy ditëve. Ky vendim është i formës së prerë.
- Në rast se vërtetohen praktika e gabuar e vlerësimit atëherë, me propozimin e përgjegjësit të departamentit, dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe për ridhënien e provimit brenda ditës ose të nesërmen e marrjes së vendimit



Sistemi i vlerësimit

- Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash.
- Nota kaluese më e ulët është nota 5.
- Në format e kontrollit me shkrim dhe me gojë përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë. *Konvertimi i pikëve në notë bëhet sipas kësaj skeme:*

0- 39 pikë- nota 4;

40-50 pike- nota 5;

51-60- nota 6;

61-70 pike- nota 7;

71-80 pike- nota 8;

81-90 pike- nota 9;

91-100 pike- nota 10.

- Për vlerësimin përfundimtar të studentit mblidhen pikët e vlerësimit të vazhduar me vlerësimin në provim

Njohja me rezultatet

- Pedagogu bën me dije rezultatet në përfundim të provimit me gojë dhe, për provimin me shkrim, brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të tij.
- Në rast se provimi zhvillohet në formën e pyetjeve me përgjigje alternative, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjeve.
- Studentët, që nuk kanë mundur të informohen në kohë mbi rezultatet e provimit, informohen pranë sekretarisë së departamentit.
- Çdo student ka llogarinë e tij ku njihet me rezultatet e provimeve.

Nr.	Emri Mbiemri	Pjesëmarrja (fiton/nuk fiton) Frekuentimi	Vlerësimi I vazhduar	Provimi përfundimtar pikë	Shuma pikë	Nota
a		1	2	3	4 (2+3)	5
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						

**Zyrat e
informacionit**

**Mos harroni
fjalëkalimin**


Riprovimet dhe mbartja e provimeve



- Studenti, i vlerësuar mbetës në dy sezonet e rregullta të provimeve (të dimrit dhe të verës), ka të drejtë të përdorë të gjitha datat e shpallura nga njësia kryesore në sezonin e vjeshtës.
- Për të kaluar në vitin e dytë (semestri i tretë), studenti duhet të ketë përfituar minimumi 20 kredite.
- Për të kaluar në vitin e tretë (semestri i pestë), studenti duhet të ketë përfituar minimumi 60 kredite nga viti i parë dhe i dytë i programit të studimit.
- Ridhënia e provimeve për lëndët e pashlyera, lejohet gjatë vitit në vazhdim në sezonet e shpallura të provimeve
- Për të kaluar në semestrin e parë të vitit të dytë, studenti që ndjek studimet në ciklin e dytë, “**Master i Shkencave**”, duhet të ketë përfituar minimumi 45 kredite.
- Studenti i vitit të fundit, i cili, në përfundim të provimeve të vitit të tretë, rezulton me detyrime mësimore, i shlyen ato në sezonin e vjeshtës dhe diplomën e mbron në këtë sezon.

E drejta e studentit për përmirësim note

- Studenti ka të drejtë të përmirësojë notat e 2 lëndëve për çdo vit akademik, në rast se i ka shlyer të gjitha detyrimet paraardhëse.
- Studenti provohet vetëm një herë për përmirësim note dhe vetëm në sezonin e riprovimeve (vjeshtë).
- Mbetet në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund.
- Kërkesa për përmirësim note i paraqitet sekretarisë mësimore para sezonit të riprovimeve.



Vlerësimi moral për studentët



- Studentët që, në përfundim të studimeve të plota, kanë të gjitha notat dhjeta, fitojnë “Medalje të Artë” me certifikatën përkatëse.
- Ata që kanë jo më pak se 70% të notave dhjeta dhe pjesën tjetër nënta, fitojnë certifikatën “Student i Shkëlqyer”.
- Për studentët që fitojnë “Medalje të Artë” ose Certifikatën “Student i Shkëlqyer”, ceremonia organizohet në shkallë Universiteti dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Rektori.



Edhe ti mund të jesh
pjesë e Këshillit!

Këshilli Studentor

- Organizëm i pavarur i studentëve.
- Nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike.
- Promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UK.
- Shpreh mendime dhe propozime për çdo problem me interes të përgjithshëm.
- Trajton shqetësimet e studentëve dhe vepron për zgjidhjen e tyre.
- Krijon struktura që shërbejnë për informimin e studentëve.
- Përforcon lidhjen **STUDENT - UNIVERSITET**



KËSHILLI I STUDENTËVE I FAKULTETIT zgjidhet me votim nga të gjithë studentët e atij fakulteti. Ai ka në përbërje të tij përfaqësues të studentëve nga të gjitha programet e studimit.

Të drejtat e studentit

- **Të zgjedhin dhe të zgjidhen** si përfaqësues në organet vendimarrëse të UK-së.
- Të ndjekin të gjitha veprimtaritë mësimore që zhvillohen në kuadrin e programit të studimit ku ata janë regjistruar.
- Të përfitojnë bursë studimi kur përmbushin kriteret e përcaktuara në VKM.
- Të përdorin infrastrukturën që UK-ja vë në dispozicion të procesit mësimor.
- Të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në UK.
- Të zgjedhin dhe të zgjidhen në Këshillin e Studentëve të njësive kryesore përkatëse, si dhe në atë në nivel institucioni.

Detyrat e studentit

- Të zbatojnë rregullat e përcaktuara në Statut, si dhe në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të UK-së dhe njësisë kryesore
- Të respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë.
- T'u kushtojnë vëmendjen e duhur studimeve dhe të marrin pjesë në veprimtaritë akademike.

Shkeljet!

Kujdes!

Veprimet që çenojnë:

- *personalitetin e pedagogut apo të çdo punonjësi tjetër të shkollës;*
- *normat etiko-morale të shoqërisë, si: kopjimi në provime;*
- *falsifikimi i dokumenteve të ndryshme zyrtare, etj;*

Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto **masa disiplinore**: a) vërejtje me shkrim; b) përjashtim nga shkolla për një vit; c) përjashtim nga Universiteti.

Qendra e Karrierës



- QKA funksionin si një zyrë për të ndihmuar nxënësit nga gjimnazi (maturantët) derisa të hedhin hapat e para profesionale. Në vazhdim, kjo qendër mban lidhje të vazhdueshme për ecurinë profesionale të ish-studenteve të saj.
- Urë lidhëse midis studentëve (punëkërkues) dhe punëmarrësve (biznesi, administrata publike).
- Synon të inkurajojë studentët në planifikimin e karrierës nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullkta, takimeve të studenteve etj.



Qendra e Karrierës



Misioni: Të ofrojë shërbimin e mbështetjes së maturantëve para dhe gjatë procesit të pranimit në UK si edhe të ofrojë shërbimet më të mira për studentët e ardhshëm, studentët aktualë, të diplomuarit, stafin dhe grupet e tjera të interesit, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e edukimit dhe t'i ndihmojë ata të zhvillojnë potencialin e plotë, për të patur një ndikim domethënës në tregun e punës dhe shoqëri.

Tre shtyllat e veprimtarisë!

MATURANT

STUDENT

ALUMNI

Tre format e veprimtarisë!

INFORMIM

TRAJNIM

NDËRMJETËSIM

Qendra e Karrierës

Shërbimet që ofron QKA:

- Informim dhe Orientim Profesional
- Këshillim Profesional
- Seanca informuese punësimi
- Vullnetarizëm dhe mbështetje
- Profil Virtual
- Rrjeti Alumni



Qëndroni në kontakt:



Email: qk.uniko@gmail.com

romeo_terolli@hotmail.com

Adresa: Qendra e Karrierës dhe Alumni
kati i dytë, godina e Rektoratit (Shëtitorja “Rilindasit”)



Për informacion ju mund të drejtoheni pranë:

- QENDRËS SË INFORMIMIT

Si dhe të hyni në faqen e internetit të Universitetit apo Fakultetit tuaj:

www.unkorce.edu.al





Duke ju falënderuar, ju urojmë

***SUKSESE NË RRUGËN TUAJ TË
DIJES.***

Çdo student ka një të drejtë dhe një detyrë:

Të studiojë dhe të studiojë!